

VENDIM
Nr. 437, datë 22.5.2013

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË PAGESËS PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË PËRKOHSHE NË MINISTRINË E DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr. 7829, datë 14.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, të nenit 13 të ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentin”, të ndryshuar dhe të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e emëruar në komisionet e përkohshme, që funksionojnë pranë Ministrisë së Drejtësisë, përfitojnë një pagesë për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në këto komisione.

2. Emërtesa e komisionit, numri i anëtarëve për çdo komision dhe masa e pagesës së anëtarëve të komisioneve përcaktohen sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Çdo pagesë e anëtarëve të komisioneve bëhet në bazë të dokumentit (listëprezencës ose procesverbalit) që vërteton pjesëmarrjen në komision.

4. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga 1 janari 2013 dhe kostot financiare të tij përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Drejtësisë.

5. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

LISTA E EMËRTESES SË ÇDO KOMISIONI, NUMRI I ANËTARËVE NË PËRBËRJE TË TYRE, SI DHE MASA E PAGESËS SË KRYETARIT DHE ANËTARËVE PËR ÇDO KOMISION

Institucioni buxhetor	Pagesa e bordit/këshillit/komisionit	Përbërja				
		Ligji	Kryetari	Nr. i anëtarëve	Shpërblim kryetari (lekë)	Shpërblim anëtar (lekë)
	Komisioni i kualifikimit të noterëve	Ligji nr. 9720, datë 23.4.2007	0	5	0	20 000
	Komisioni i hartimit të tezës për provimin e noterisë	Ligji nr. 10 296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (neni 28)	0	2	0	15 000
	Komisioni i administrimit të provimit të noterisë	Ligji nr.9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (neni 20)	1	5	5 000	5 000
	Komisioni i kualifikimit të përmbartuesve gjyqësorë privatë		0	3	0	20 000
	Komisioni i hartimit të tezës së përmbartuesve gjyqësorë privatë		0	2	0	15 000

	Komisioni i administrimit të provimit të përmbauesve gjyqësorë privatë		1	5	5 000	5 000
Ministria e Drejtësisë	Komisioni i testimit të kandidatëve për përkthyes të jashtëm		0	15	0	10 000
	Komisioni i hartimit të tezës për provimin për përkthyes të jashtëm		0	5	0	10 000
	Komisioni i administrimit të provimit për përkthyes të jashtëm		1	5	5 000	5 000
	Komisioni i hartimit të tezës të provimit të kualifikimit për ushtrimin e profesionit të administratorit të falimentit		0	2	0	10 000
	Komisioni i administrimit të procesit të provimit të kualifikimit për ushtrimin e profesionit të administratorit të falimentit		0	6	0	5 000
	Komisioni i kualifikimit të administratorëve të falimentit		0	3	0	15 000